



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË

BASHKIAVAU DEJËS

SHPALLJE PËR VEND PUNE
(shtyerje afati për dorëzim dokumentash)

**Për zbatimin e Programit të përbashkët të kombeve të Bashkuara
“Askush të mos mbetet pas” Faza 2/LNB2F”**

Bazuar në Ligjin nr 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, si dhe Marrvëveshjes Standarte mes Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim dhe Bashkisë Vau Dejës mbi Zbatimin e Programit të përbashkët të kombeve të Bashkuara “Askush të mos mbetet pas” Faza 2/LNB2F datë 23.06.2023 të lidhur ndërmjet UNDP dhe Bashkisë Vau Dejes, Bashkia Vau Dejes shpall procedurat e konkurimit për vendin e lirë:

Fizioterapist

I-Pozicioni i Fizioterapistit

a-Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore

- ✓ Diagnostikon, realizon vlerësimë të përshtatshme dhe ndërhyrje me fëmijë me spektër të gjera nevojash përfshirë fizioterapi, duke përdorur mjete vlerësimi të përshtatshme.
- ✓ Kryen ndërhyrje fizioterapie përfshirë fëmijët me spektër të gjerë çrrregullimesh duke përfshirë tregjitha specialitetet pediatrike.
- ✓ Modelon punën, përfshin, udhëzon familjen mbi teknikat/aktivitetet kryesore fizioterapeutike me fëmijën e tyre.
- ✓ Merr pjesë në hartimin e planit personal të zhvillimit të fëmijës në bashkëpunim me ekipindhe familjen e profesionistë të tjera.
- ✓ Mban të dhënat përfshirë punën e kryer me fëmijën në mënyrë të qartë në përputhje me standarde profesionale.
- ✓ Formulon dhe ndjek/zbaton programe individuale trajtimi bazuar në informacionin emarrë nga vlerësimi i tij dhe ekipi.
- ✓ Kryen ndërhyrje trajtuese duke u përshtatur me barrierat dhe kushtet e vendit ku ndodhet fëmija, dinamikat e vetë fëmijës dhe familjes.
- ✓ Vlerëson ndërhyrjen e bërë dhe progresin e fëmijës përmes reflektimit, analizës dhemjeteve objektive të dokumentuara me kujdes.
- ✓ Këshillon/edukon fëmijën dhe tij si të menaxhojnë, minimizojnë riskun e dëmtimit të fëmijës (p.sh. gjatë lëvizjes) dhe si të parandalojnë e përmirësojnë gjendjen fizike të tij.
- ✓ Në bashkëpunim me ekipin shkëmben informacion përfshirë backgroundin dhe progresin efëmijës si dhe referon tek shërbime komunitare fëmijët që kanë nevojë përfshirë vëmendje

- ✓ Informimi i prinderve të fëmijes përfitues për rëndësinë e trajtimit shendetësor dhe psikologjik bazuar në nevojat specifike të fëmijës.
- ✓ Krijimi i skedave të përsonalizuara për secilin fëmijë si dhe detajimi i përshkrimit të punës edhe të prinderve me fëmijët në përditshmërinë e tyre.
- ✓ Takime dhe informim i mesuesve mbeshtetës të fëmijeve që ndjekin shkollat për planin e ndërhyrjes në mënyrë që të bëhet një mirëkoordinim i punës mes profesionistit prinderit dhe mësuesit mbështetës te fëmijës.

b-Kualifikimet dhe Cilësítë

- ✓ Diplomë e në degën fizioterapi.
- ✓ Të ketë përvojë si fizioterapist, në profesion (prioritet përvojë në punën me fëmijët me aftësi të kufizuar)
- ✓ I aftë fizikisht dhe teknikisht të përshtasë trajtimin fizioterapeutik në mjedise/rrethana tëvështira e me hapësira të vogla
- ✓ Gëzon integritet individual dhe profesional si dhe pjekuri emocionale
- ✓ Aftësi të mira planifikuese dhe organizative, negociuese dhe në zgjidhjen e konfliktit
- ✓ Aftësi të mira interpersonale e i aftë të punojë me grupe të ndryshme njerëzish në mënyrëprofessionale dhe etike
- ✓ Ka respekt për të drejtat themelore, dinjitetin e fëmijës dhe familjes
- ✓ Ka pasion për punën dhe ndihmën ndaj njeriut
- ✓ Njohuri të mira për të drejtat e fëmijës dhe çështje të mbrojtjes së fëmijës
- ✓ Gjuha angleze (e preferuar)

c-Paga

- ✓ Pagado të jetë 1200 lekë /Ore

d-Vendi dhe koha e punës.

- ✓ Fizioterapisti do të punojë në zonën e Njësia Administrative Vau Dejës dhe Hajmel. Në përputhje me Kontraten e Punës se shërbimit, personi i kontraktuar Psikologu do të ofrojë 560 senaca të shpërndara ne 28 Fëmijë me Aftësi të Kufizuar.

e-Dokumentacioni

- Një letërinteresi
- Një CV

Dokumentacionidotëdorëzohet personalisht ngakandidatët pranë Drejtorisë së Burimeve Njërezore, Bashkia Vau Dejes.

f-Procedura e përzgjedhjes dhe shpalljet së kandidatit fitues

- Kandidatët të cilët kanë shprehur interes për këtë pozicion pune do të përzgjidhen nga Komisioni i Posaçëm i ngritur për këtë procedurë konkurrimi.
- Shpallja e fituesitdo të publikohet në faqen zyrtare të Bashkisë Vau Dejës

g-Afatit i dorëzimit të dokumentacionit

- Afati për dorëzimin e dokumentacionit do të jetë deri në datën 01.08.2023 , ora 15:00.